

EC

MA NDRYSHE

EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RIKIKLO -

EKO KLUBI

"12 MAJI"



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

CARITAS

Schweiz
Suisse
Svizzera
Svizra

YENI

YOUTH
ENVIRONMENTAL
IMPACT



Të dashur lexues,

Kjo është seria e tretë e buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i Shkollës së Mesme të Lartë “12 Maji” dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit “ECO School”.

Ky projekt do t’i njohë me konceptin “Eko Shkolla” 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimeve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).

MBETURINAT

Mbeturina është sasia e mbetur nga diçka (nga ndonjë gjësend) e që nuk ka ndonjë vlerë të caktuar.

Mbeturinat zakonisht krijohen gjatë përpunimit dhe transformimit të materieve dhe formave të energjisë. Në jetën e përditshme dallohen dy lloj mbeturinash ato industriale dhe të punishteve. Mbeturinat mund të shkaktojnë dëme në shëndetin dhe jetën e njerëzve nëpërmjet krijimit të nxitësve të sëmundjeve.

Era dhe pamja ndikojnë jo vetëm në tokë por edhe në ambient në përgjithësi, në ajër e ujë.

Sasia mesatare e mbeturina për kokë të njeriut brenda një viti fitohet kur të merret sasia e përgjithshme e mbeturinave e shprehur në kubik metër për numrin e përgjithshëm të banorëve. Në Gjermanin Federale në vitin 1984 është llogaritur të ketë qenë diku 1 metër kubikë për kokë banori.



MENAXHIMI I MBETURINAVE



Menaxhimi i mbeturinave si problematik ka filluar të paraqitet që në krijimin e qyteteve të para. Përderisa në kohërat e mëparshme ato janë mėnjanuar me ndihmėn e lumenjve sot ato duhet të pėrpunohen nė njė mėnyrė tē atillė qē tē mos e dēmtojnė ambientim. Mbeturinat e pėrpunuara duhet deponuar a zhdukur. Mbeturina e dedikuara pėr shtypje (komprimim) duhet kryesisht tē jenė organike. Mbeturina tē tilla vijėn nga pėrdorimi i ushqimit, pemėt, mbeturinat e kafshėve, punishtet e fabrikat pėrpunuese tē drurit dhe industrisė sė letrės; para sė gjithash mbeturinat industriale nuk mund tē deponohen. Vetitė e tilla tē mbeturinave kėrkojnė trajtime tē veçanta. Pėr mbledhjen e mbeturinave tē rrezikshme ndėrtohen depo tē posaçme. Mbeturinat tjera industriale pėr shkak tē natyrės sė veçantė qē kanė digjen nē furrat e mbeturinave nē tē cilat digjen edhe trupa tē kafshėve apo mbeturinave tjera qē nē vete kanė substanca helmuese. Mbeturinat e lėngėta radioaktive transformohen nē koncentrat dhe hiri qē mbetet nga ato ruhet nē depo tē veçanta. Mė problematike ėshtė mėnjanimi i gazeve radioaktive. Pėr kėto mbeturina janė tē parapara mbajtės tē qėndrueshėm ndaj ndryshkjes, shtypjes , nxehtėsisė dhe izolues tē radioaktivitetit. Kėto mbajtėse tē mbeturinave deponohen nē depo nėntokėsore qē zakonisht ndėrtohen nē gropa kripe.

MENAXHIMI I MBETURINAVE




Menaxhimi i mbeturinave në shtete të ndryshme të botës është paraparë me ligj dhe sipas nevojës dhe zhvillimit teknologjik të vendeve bëhen ndryshime edhe të ligjit. Për menaxhimin e mbeturinave përgjegjëse zakonisht janë komunat të cilat mund të angazhojnë firma të ndryshme private për këtë qëllim. Depot e mbeturinave duhet përmbushur disa parakushte dhe për përmbushjen e tyre përkujdesen zyrtarët e komunës. Për mbeturinat e posaçme (mbeturina vajguri e radioaktive) parashihen ligje të posaçme.



DISA FAKTE

INTERESANTE RRETH MJEDISIT



1. Që nga viti 1950, rreth 8.3 miliardë tonë plastikë janë prodhuar në mbarë botën.
2. Në disa pjesë të botës, përdorimi i plastikës është tashmë i paligjshëm.
3. 73% e mbeturinave të plazhit në mbarë botën janë plastike.
4. Një milion shishe plastike janë blerë në mbarë botën çdo minutë.
5. Në botë, çdo minutë përdoren rreth 2 milionë qese plastike.
6. 90% e plastikës që ndot oqeanet tona bartet vetëm nga 10 lumenj.
7. Plastika është duke vrarë më shumë se 1.1 milion zogj të detit dhe kafshë.
8. Një person ha mesatarisht 70,000 mikroplastikë çdo vit.
9. Koha mesatare që përdoret një qese plastike është ... 12 minuta.
10. Gjatë 50 viteve të fundit, prodhimi botëror i plastikës është dyfishuar.

EKO KLUBI "12 MAJ"

RATKOC, RAHOVEC, KOSOVË

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit “Ndikimi i Rinisë në Mjedis” - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit “ECO Schools”.